



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR



STRUKTURA E POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

RAPORTI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT
12 maji 2025

Shkurt 2026

Kuadri Ligjor Rregullator

1. Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar,
2. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
3. Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
4. Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar,
5. Ligji nr.162/2020 “Për prokurimet Publike” i ndryshuar,
6. Ligji nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar,
7. Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”
8. Udhëzimit Nr.14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”
9. Udhëzimit nr. 2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”,
10. VKM 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik i ndryshuar”
11. VKM nr.325 dt.31.05.2023 “Për miratimin e Strukturës dhe Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë/Nëpunësve, Zëvendësministrit dhe Nëpunësve të Kabineteve në disa institucione të Administratës Publike” të ndryshuar.
12. VKM nr.326 dt.31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në institucione të Administratës Publike” të ndryshuar,

TABELA E PËRMBAJTJES

- 1. HYRJE*
- 2. INFORMACIONI BUXHETOR I AGREGUAR*
- 3. PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE.
NË NIVEL PRODUKTI*
- 4. PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT*
 - 4.1 PERFORMANCA FINANCIARE E PROGRAMT BUXHETOR*
 - 4.2 PERFORMANCA JO-FINANCIARE E PROGRAMIT BUXHETOR*
 - 4.3 VEPRIMET VLIJUESE NË NIVELIN E PROGRAMIT BUXHETOR*
- 5. PROJEKTET KAPITALE*
- 6. NDRYSHIMET NË BUXHET*
- 7. PËRFUNDIME*

1 HYRJE

Në zbatim të Udhëzimit Nr.14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, si dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Strukturat e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar kanë përgatitur Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për periudhën 12-mujore të vitit 2025.

Monitorimi i zbatimit të buxhetit 12-mujor për SPAK-un përfaqëson një proces analitik dhe vlerësues, i cili synon:

- krahasimin e treguesve faktikë të performancës me treguesit e planifikuar në buxhetin e miratuar;
- vlerësimin e nivelit të realizimit të fondeve buxhetore sipas programeve, nënprogrameve dhe treguesve të performancës;
- identifikimin e devijimeve, shkaqeve të tyre dhe masave korrigjuese të ndërmarra ose të nevojshme për periudhat në vijim.

Strukturat përgjegjëse të SPAK-ut kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë në mënyrë të vazhdueshme, me fokus ndjekjen e realizimit të objektivave strategjikë të institucionit, garantimin e përdorimit efikas dhe efektiv të fondeve publike, si dhe respektimin e të gjitha kërkesave ligjore dhe rregullative në fushën e menaxhimit financiar publik.

Nëpërmjet këtij raporti evidentohet qartë niveli i realizimit të buxhetit në krahasim me planin e miratuar, i detajuar sipas treguesve të performancës, duke ofruar një panoramë të plotë mbi lidhjen ndërmjet burimeve financiare të përdorura dhe produkteve apo rezultateve të arritura.

Analiza e monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor i shërben institucionit si një instrument i rëndësishëm menaxherial, duke mundësuar:

- përmirësimin e procesit të planifikimit buxhetor në vitet pasuese;
- rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në përdorimin e fondeve publike;
- forcimin e lidhjes ndërmjet kostove buxhetore dhe performancës institucionale.

Ky raport zyrtar përbën një pasqyrë të rëndësishme përmes së cilës SPAK synon të konsolidojë qasjen e buxhetimit të bazuar në performancë, si dhe të sigurojë një vlerësim financiar të qëndrueshëm dhe të argumentuar mbi ecurinë e institucionit gjatë vitit 2025.

2 INFORMACIONI BUXHETOR I AGREGUAR

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtaria e Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”, mbështetet në Deklaratën e Politikës së Programit të hartuar në kuadër të procesit të PBA 2025-2027 dhe është në funksion të realizimit të Politikës së Programit në përputhje me misionin dhe funksionet e tij kushtetuese dhe ligjore.

Buxheti i Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2025 është miratuar me ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, ku në fillim të vitit buxhetor rezultoi një fond fillestar i akorduar në shumën 2,370 milion lekë.

Gjatë zbatimit të buxhetit, në përputhje me aktet normative dhe vendimet përkatëse për rishikimin e buxhetit, fondi i këtij programi është rishikuar në shumën 1,480 milion lekë nga të cilat:

- Buxheti për Prokurorinë e Posaçme në shumën 1,047 milion lekë
- Buxheti për Byronë Kombëtare të Hetimit në shumën 433 milion lekë

Tabela nr. 1: Plani buxhetor për vitin 2025

(000/lekë)

Titulli	Emërtimi	Plani Fillestar Vjetor	Plani Vjetor i Rishikuar	Shpenzime Faktike	Diferenca	% e realizimit fakt/plan
1	2	3	4	5	6=(4-5)	7=(5/4)
03390	Veprimtaria e SPAK	2,369,963	1,480,420	1,351,505	128,915	91%
Totali i Shpenzimeve të Institucionit		2,369,963	1,480,420	1,351,505	128,915	91%

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2025);

Niveli i realizimit të fondeve buxhetore të SPAK-ut në krahasim me planin e miratuar paraqitet në masën 91 %.

Duke u mbështetur në veprimtarinë bazë të institucionit, pjesë përbërës e të cilit janë:

1. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me kod institucioni në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë 1041001,
2. Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) me kod institucioni në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë 1041002,

Në analizë të informacionit të paraqitur në mënyrë tabelare, rezultoi se:

- a) Sipas planit fillestar të miratuar shuma prej 1,670 milion lekë përfaqëson shpenzimet korrente dhe shuma 700 milion lekë shpenzimet kapitale.
- b) Gjatë 12-mujorit të vitit 2025, plani fillestar ka pësuar rishikime të njëpasnjëshme, si rezultat i detajimeve të fondit të veçantë, kërkesave shtesë, si dhe ndryshimeve të reflektuara përmes akteve normative.

Sipas planit të rishikuar shuma prej 1,122 milion lekë përfaqëson shpenzimet korrente, dhe shuma 358 milion lekë shpenzimet kapitale.

Në zërin e shpenzimeve korrente janë reflektuar shtesa të fondit të veçantë, konkretisht:

- me shkresën nr. 3067/1, datë 19.02.2025, është miratuar vlera 350 mijë lekë;
- me shkresën nr. 6054/1, datë 14.04.2025, është miratuar shtesa 648 mijë lekë;
- me shkresën nr. 42995, datë 16.12.2025, është miratuar shtesa 1,112 milion lekë.

Paralelisht me këto shtesa, gjatë vitit 2025 janë reflektuar edhe pakësime buxhetore të konsiderueshme, të miratuara përmes akteve normative. Në përmbledhje, pakësimet totale të miratuara me akte normative gjatë vitit 2025 arrijnë në shumën 891 milion lekë, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në uljen e planit fillestar.

- c) Sipas realizimit faktik, totali i shpenzimeve të realizuara është në shumën 1,352 milion lekë ose 91% e planit të rishikuar, të rakorduara edhe me të dhënat e sistemit SIFQ,
- shpenzimet korrente janë realizuar në masën 71%, në vlerë 1,059 milion lekë e realizimit faktik
 - shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 20%, në vlerë 293 milion lekë e realizimit faktik

Tabela nr.2: Raporti i shpenzimeve të programit sipas llogarive ekonomike

(000/lekë)


Art.	Emërtimi	Fakti i vitit paraardhës 2024	1	2	3	4=(2-3)	Përqindja e realizimit Fakt/Plan (%)
			Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2025	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2025	Fakti periudhës 12 - mujore	Diferenca Plan - Fakt	
600	Paga	749,365	1,285,496	817,896	808,037	9,859	99%
601	Sigurime Shoqërore	63,448	136,000	74,763	68,720	6,043	92%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	160,908	248,117	225,287	178,280	47,007	79%
603	Subvencione	0	0	0	0	0	
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0	0	0	
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	1,830	1,830	0	100%
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	984	0	2,110	1,919	191	91%
Nën-Totali	Shpenzime Korrente	974,705	1,669,613	1,121,886	1,058,786	63,100	94%
231	Kapitale të Trupëzuara	249,395	700,000	358,534	292,719	65,815	82%
Nën-Totali	Shpenzime Kapitale	249,395	700,000	358,534	292,719	65,815	82%
Totali (korrente + kapitale)		1,224,100	2,369,613	1,480,420	1,351,505	128,915	91%

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2025);

Për sa i përket faktik krahasuar me buxhetin vjetor përfundimtar, rezulton se niveli i realizimit sipas zërave kryesorë buxhetorë paraqitet përgjithësisht i kënaqshëm, duke reflektuar një administrim të qëndrueshëm dhe të kontrolluar të fondeve buxhetore gjatë vitit 2025.

Në tërësi, realizimi i buxhetit është përqëndruar kryesisht në zërat me peshën më të madhe buxhetore, ku shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore janë realizuar në nivel të lartë (rreth 96%), duke garantuar funksionimin normal të institucionit. Mallrat dhe shërbimet me peshë të konsiderueshme, por më fleksibël, paraqesin realizim rreth 79%. Transferrat buxhetore janë realizuar rreth 95%, ndërsa Investimet kapitale si zë me peshë më të ulët por me ndikim afatgjatë, janë realizuar rreth 82%, kryesisht për shkak të rishikimit të projekteve.

Grafiku nr.1: Struktura e realizimit Fakt - Plan për vitin 2025



Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2025);

Struktura e shpenzimeve 2025

Analiza e strukturës së shpenzimeve sipas peshës specifike ofron një pasqyrë të detajuar mbi mënyrën e shpërndarjes dhe menaxhimit të fondeve buxhetore, duke mundësuar identifikimin e ndryshimeve dhe devijimeve ndërmjet buxhetit fillestar, buxhetit të rishikuar dhe realizimit faktik.

Tabela 3: Raporti struktural e shpenzimeve në përqindje

Në 000/lekë

Art.	Emertimi	Plani Fillestar Vjetor 2025	Struktura e shpenzimeve	Plani Vjetor i Rishikuar 2025	Struktura e shpenzimeve	Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve
1	2	3		4		5	
600	Paga	1,285,496	54%	817,896	55%	808,037	60%
601	Sigurime Shoqërore	136,000	6%	74,763	5%	68,720	5%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	248,117	10%	225,287	15%	178,280	13%
606	Transferta Korente të Huaja	0	0%	1,830	0%	1,830	0%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	0%	2,110	0%	1,919	0%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	1,669,613	70%	1,121,886	76%	1,058,786	78%
231	Kapitale të Trupëzuara	700,000	30%	358,534	24%	292,719	22%
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	700,000	30%	358,534	24%	292,719	22%
Totali (korrente + kapitale)		2,369,613	100%	1,480,420	100%	1,351,505	100%

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2025);


Në fazën e planifikimit buxhetor, shpenzimet janë kategorizuar në zëra kryesorë sipas klasifikimit ekonomik, ku secili zë, zë një peshë të caktuar në totalin e buxhetit të rishikuar.

Nga analiza e peshës specifike të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2025, rezulton se zëri i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore përbën pjesën më të madhe të fondeve të planifikuara, duke zënë rreth 60% të totalit të buxhetit të rishikuar, në krahasim me zërat e tjerë buxhetorë.

Sipas analizës së realizimit faktik për vitin 2025, struktura e shpenzimeve tregon se zëri i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore zë peshën më të madhe, duke përbërë rreth 65% të totalit të shpenzimeve të realizuara.

Në të kundërt, zëri i shpenzimeve për transfertat për buxhetin familjar zë peshën më të vogël, ndërsa zërat e tjerë paraqiten me peshë të ndërmjetme në strukturën e shpenzimeve faktike.

Grafiku 2: Pësha sipas llogarive ekonomike e plani/fakt të buxhetit 2025



Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2025);

3 PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE, NË NIVEL PRODUKTI

Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, bazuar në orjentimet e Ministrisë së financave, në kuadër të PBA, ka parashikuar tregues performance me bazë gjinore në nivel produkti. Treguesi i parashikuar është: **% e grave në poste drejtuese të institucionit ndaj totalit të posteve drejtuese.**

Tabela nr.4: Raporti i posteve gra në nivel drejtuesi

SPAK	Fakt Nr. i Funksioneve në nivel drejtues	Fakt Nr. i Funksioneve në nivel drejtues Gra	% e posteve drejtues Gra/Totalin
Prokuroria e Posaçme	18	8	44%
Byroja Kombëtare e Hetimit	9	5	56%
Totali	27	13	48%

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, SPAK (2025);

Ky tregues jo vetëm që pasqyron angazhimin e institucionit për rritjen e përfaqësimit të grave në nivelet vendimmarrëse, por gjithashtu ndikon në zhvillimin e efekteve pozitive për të integruar barazinë gjinore në të gjitha aspektet e veprimtarisë së tij.

Gjithashtu, në kuadër të PBA-së dhe buxhetimit gjinor, treguesi kontribuon në identifikimin dhe monitorimin e rezultateve të politikave dhe ndërhyrjeve buxhetore që synojnë reduktimin e pabarazive gjinore dhe rritjen e aksesit të grave në pozicione vendimmarrëse.

Fakti që **48% e posteve drejtuese (në nivele të larta, mesme dhe të ulëta drejtuese) mbahen nga gra** tregon një nivel domethënës përfaqësimi dhe dëshmon për angazhimin institucional drejt zbatimit të parimit të barazisë gjinore. Megjithatë, ky nivel evidenton gjithashtu nevojën për vijimin e përpjekjeve për rritjen graduale të pjesëmarrjes së grave në role drejtuese, në përputhje me objektivat e PBA-së dhe standardet e qeverisjes së mirë.

Grafiku nr.3: Numri i posteve drejtuese gra ndaj totali të posteve drejtuese



Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2025);

Në këtë kuptim, treguesi gjinor nuk është vetëm një matës statistikor, por një element thelbësor i llogaridhënies institucionale dhe i integritimit të perspektivës gjinore.

4 PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT

4.1. PERFORMANCA FINANCIARE E PROGRAMT BUXHETOR

Referuar të dhënave të tabelës, realizimi i shpenzimeve sipas zërave për 12-mujorin e vitit 2025 tregon se buxheti i institucionit është realizuar në masën rreth 91% të buxhetit të rishikuar, krahasuar me një realizim prej 93% për vitin 2024.

Tabela nr. 5: Diferenca Plan/Fakt shpenzimeve të programit sipas llogarive ekonomike. Në 000/ lekë

	Buxheti fillestar	Buxheti i Rishikuar	Fakti	% e realizimit	Buxheti fillestar	Buxheti i Rishikuar	Fakti 12 mujor Janar - Dhjetor	% e realizimit
Artikujt	2024	2024	2024	2024	2025	2025	2025	2025
Paga (600-601)	1,102,946	855,946	812,813	95%	1,421,496	892,659	876,757	98%
Korente të Tjera (602-606)	248,117	186,601	161,892	87%	248,117	229,227	182,029	79%
Kapitale (230-232) Të Brendshme	550,000	268,000	249,395	93%	700,000	358,534	292,719	82%
Kapitale (230-232) Të Huaja	-	-	-	-	-	-	-	-
Jashtë-buxhetore	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali	1,901,063	1,310,547	1,224,100	93%	2,369,613	1,480,420	1,351,505	91%

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2025);

Nga krahasimi i performancës faktike ndërmjet dy viteve rezulton se shpenzimet e realizuara për vitin 2025 janë rreth **127 milion lekë më të larta** se në vitin 2024, duke kaluar nga 1,224 milion lekë në 1,351 milion lekë. Kjo rritje reflekton:

- një orientim më të madh të fondeve drejt shpenzimeve prioritare, kryesisht për paga dhe sigurime shoqërore;
- ndikimin e ndryshimeve në planifikimin dhe rishikimin e fondeve gjatë vitit 2025;
- nevojën për të mbuluar kostot operative dhe investimet e kryera gjatë periudhës 12-mujore.

Tabela nr. 6: Diferenca Plan/Fakt shpenzimeve të programit sipas llogarive ekonomike. Në 000/ lekë

Art.	Emertimi	Fakti i vitit paraardhes per 12 mujor 2024	Plani Fillestar Vjetor 2025	Plani Vjetor i Rishikuar 2025	Shpenzime Faktike per 12 mujor 2025	Ndryshimi vjetor (Plan-Fakt)
1	2	3	4	5	6	7=(5-6)
	Prokuroria e Posacme					
600	Paga	368,989	500,496	419,496	409,727	9,769
601	Sigurime Shoqërore	34,755	68,000	44,500	38,457	6,043
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	158,138	223,117	223,117	176,584	46,533
605	Transferata Korente të Huaja			0	0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	924		1,461	1,270	191
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	562,806	791,613	688,574	626,038	62,536
231	Kapitale të Trupëzuara	249,395	700,000	358,534	292,719	65,815
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	249,395	700,000	358,534	292,719	65,815
	Totali (korrente + kapitale)	812,201	1,491,613	1,047,108	918,757	128,351
	BKH					
600	Paga	380,376	785,000	398,400	398,310	90
601	Sigurime Shoqërore	28,693	68,000	30,263	30,263	0
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	2,770	25,000	2,170	1,696	474
605	Transferata Korente të Huaja			1,830	1,830	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	60		649	649	0
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	411,899	878,000	433,312	432,748	564
231	Kapitale të Trupëzuara		0	0	0	0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	0	0	0	0	0
	Totali (korrente + kapitale)	411,899	878,000	433,312	432,748	564
	Totali (SPAK)	1,224,100	2,369,613	1,480,420	1,351,505	128,915

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2025);

Megjithëse niveli i realizimit për vitin 2025 (91%) është pak më i ulët se ai i vitit 2024 (93%), vlera totale e shpenzimeve të realizuara është më e lartë, duke treguar një rritje të aktiviteteve dhe nevojave të institucionit, pavarësisht pakësimeve buxhetore dhe ndryshimeve normative të vitit 2025.

Grafiku nr.4: Krahasimi i faktikut për 12-mujorin e vitit 2024/2025



Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2025);

Krahasimi i strukturës së zërave për secilin vit gjithashtu evidenton përqendrimin më të madh të fondeve në shpenzimet për paga, ndërsa zërat e tjerë (mallra, shërbime, investime) mbeten me peshë më të ulët në strukturën e realizimit faktik.

Shpenzimet e personelit (600+601)

Plani i fondeve të akorduara nga buxheti i shtetit për Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), nëpërmjet Ligjit vjetor të buxhetit për vitin 2025, për zërin “**Paga dhe sigurime**”, (Ilogaria ekonomike 600-601) ka qenë fillimisht në shumën 1,421 milion lekë. Pas rishikimeve buxhetore të miratuara gjatë vitit, plani përfundimtar është përcaktuar në vlerën 893 milion lekë:

- Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar: 464 milion lekë;
- Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH): 429 milion lekë.

Sipas të dhënave të realizimit, Prokuroria e Posaçme dhe BKH kanë realizuar gjithsej shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore në shumën 877 milion lekë, konkretisht:

- Prokuroria e Posaçme ka realizuar shpenzime në shumën 410 milion lekë për paga dhe 38 milion lekë për sigurime, ose rreth 97% e fondit të planifikuar për vitin 2025;
- Byroja Kombëtare e Hetimit ka realizuar shpenzime në shumën 398 milion lekë për paga dhe 30 milion lekë për sigurime shoqërore, ose 100% e fondit të planifikuar për vitin 2025.

Niveli i realizimit të shpenzimeve për këtë zë tregon se fondi i pagave është administruar në mënyrë të efektshme, në përputhje me numrin real të punonjësve.

Bazuar në **ndryshimet ligjore të miratuara gjatë vitit 2025**, konkretisht:

- Aktin Normativ nr. 6, datë 11.06.2025,
 - Aktin Normativ nr. 10, datë 08.10.2025,
 - Aktin Normativ nr. 11, datë 19.12.2025,
- “Mbi ndryshimin e Ligjit nr. 115/2024 Për buxhetin e vitit 2025”,

dhe në mbështetje të deklarimeve të fondeve buxhetore të papërdorura, është miratuar një pakësim i fondeve në shumën totale prej 529 milion lekë për zërin “*Paga dhe sigurime shoqërore*” nga të cilat: (Prokuroria e Posaçme 105 milion lekë/Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) 424 milion lekë).

Deklarimi i këtyre tepricave buxhetore ka qenë rrjedhojë e drejtpërdrejtë e ekzistencës së vakancave në strukturën organike, të cilat kanë ndikuar në mosrealizimin e plotë të fondit të planifikuar për paga dhe kontribute shoqërore gjatë vitit buxhetor 2025.

Në zbatim të ligjit nr. 115/2024 “*Për buxhetin e vitit 2025*”, **struktura e miratuar** e punonjësve për Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) përbëhet nga gjithsej 322 punonjës, konkretisht 144 punonjës në Prokurorinë e Posaçme dhe 178 punonjës në Byronë Kombëtare të Hetimit (BKH).

Gjatë vitit 2025, **numri efektiv** i punonjësve rezulton të jetë 206 punonjës, nga të cilët 124 punonjës në Prokurorinë e Posaçme dhe 82 punonjës në Byroja Kombëtare e Hetimit. Krahas punonjësve organikë, në strukturë janë angazhuar edhe 4 punonjës me kontratë të përkohshme, të miratuar sipas legjislacionit në fuqi, me qëllim mbulimin e nevojave të përkohshme dhe specifike të institucionit.

Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera (602)

Aktiviteti operacional dhe hetimor i Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) gjatë vitit buxhetor 2025 është mbështetur nga buxheti i shtetit, në kuadër të zërit “**Mallra dhe shërbime**” (**Ilogaria ekonomike 602**).

Plani fillestar i miratuar për këtë zë ka qenë në shumën 248 milion lekë, ndërsa pas rishikimeve buxhetore të kryera gjatë vitit, plani përfundimtar është miratuar në shumën 225 milion lekë. Ky plan është detajuar si më poshtë:

- Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar: 223 milion lekë;
- Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH): 2 milion lekë.

Gjatë periudhës 12-mujore të vitit 2025, shpenzimet faktike paraqiten në shumën totale 178 milion lekë, ose 79% e planit vjetor përfundimtar. Nga kjo shumë:

- Prokuroria e Posaçme ka realizuar shpenzime në vlerën 176.5 milion lekë;
- Byroja Kombëtare e Hetimit ka realizuar shpenzime në vlerën 1.6 milion lekë.

Niveli i realizimit të shpenzimeve tregon një menaxhim të kujdesshëm dhe racional të fondeve buxhetore. Këto shpenzime kanë mbuluar nevoja të domosdoshme utilitare, procedurale dhe operacionale, të cilat sigurojnë funksionimin normal dhe të pandërprerë të institucionit, në përputhje të plotë me parashikimet e miratuara në Regjistrin e Prokurimeve dhe aktet nënligjore në fuqi.

Në totalin e likuidimeve të realizuara janë përfshirë, ndër të tjera, shpenzime për:

- mirëmbajtjen e sistemeve dhe infrastrukturës së teknologjisë së informacionit;
- rinovimin dhe përditësimin e programeve ekzaminuese dhe analitike;
- pagesa për shërbime kadastrale dhe shërbime të tjera teknike mbështetëse;
- honorare për ekspertë të fushave të ndryshme, avokatë dhe përkthyes, të angazhuar në kuadër të procedimeve hetimore;
- furnizimin me materiale kancelarie për nevojat e përditshme të zyrave të institucionit;
- shpenzime për karburant, shërbime utilitare, si dhe për udhëtime dhe dieta brenda dhe jashtë vendit;
- shpenzime të tjera të nevojshme për garantimin e funksionimit administrativ dhe operacional të institucionit.

Këto zëra zënë peshën më të madhe në strukturën e këtyre shpenzimeve duke garantuar sigurinë, vazhdimësinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Gjithashtu, gjatë periudhës 12-mujore janë reflektuar ndryshime në Regjistrin e Parashikimit të Procedurave të Prokurimit, të cilat janë drejtuar pranë Degës së Thesarit në mënyrë periodike, në përputhje me kërkesat operative dhe dinamiken e punës së institucionit. Këto ndryshime kanë qenë të diktuar nga nevoja për përshtatje ndaj zhvillimeve të paparashikuara dhe rritjes së kompleksitetit të procedurave.

Rritja e shpenzimeve për mallra dhe shërbime për vitin 2025, krahasuar me vitin 2024, vjen si pasojë e rritjes së ndjeshme të volumit të procedurave hetimore, shtimit të hetimeve komplekse dhe përdorimit më të gjerë të mjeteve teknologjike dhe ekspertizave të specializuara. Një faktor shtesë që ka ndikuar në këtë rritje është edhe shtimi i numrit të stafit, i cili ka sjellë rritje të drejtpërdrejtë të nevojave për mbështetje logjistike, shërbime utilitare dhe furnizime administrative.

Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë veprime për rialokimin e burimeve buxhetore, ku është realizuar një pakësim në shumën totale prej 1.8 milion lekë nga llogaria 602 dhe shtesë në llogarinë 605.

Në vijim, bazuar në **ndryshimet ligjore të miratuara gjatë vitit 2025**, dhe në mbështetje të deklarimeve të tepricave të fondeve buxhetore, është miratuar një pakësim i fondeve në shumën totale prej 21 milion lekë, për zërin “*Mallra dhe shërbime*” nga Byroja Kombëtare e Hetimit.

Shpenzimet utilitare zënë peshën rreth 41% ose 73 milion lekë dhe shpenzimet me procedura prokurimi zënë peshën 59% ose 105 milion lekë.

Për zërin mallra dhe shërbime u konstatua se realizimi faktik për vitin 2024 është 87% dhe realizimi faktik 12 mujor për vitin 2025 është 79% kundrejt planit me ndryshime.

Transferta Korrente të Huaja (605)

Shpenzimet për **Transferta të huaja (Ilogaria ekonomike 605)** për vitin 2025, bazuar në rialokimin e fondeve buxhetore të miratuara, paraqiten me një shtesë në shumën 1.8 milion lekë për Byronë Kombëtare të Hetimit (BKH).

Ky rialokim është realizuar në mbështetje të *Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Qendrës së Zbatimit të Ligjit të Europës Juglindore (SELEC)*, me nr. 527/23, datë 16.12.2024, me qëllim mbulimin e shpenzimeve për pagesën e kontributit vjetor të anëtarësimit në këtë organizatë ndërkombëtare. Kuota e anëtarësimit për BKH përcaktohet në masën 3% të kontributit total, në përputhje me aktet rregulluese të SELEC.

Për vitin 2025, realizimi faktik 12-mujor për këtë zë shpenzimesh është në shumën 1.8 milion lekë, duke shënuar një nivel realizimi 100% në raport me planin buxhetor me ndryshime.

Transferta për buxhete familjare (606)

Për vitin buxhetor 2025, në zbatim të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “*Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë*”, i ndryshuar, është planifikuar **Fondi i Veçantë (Ilogaria ekonomike 606)** për mbulimin e rasteve të fatkeqësive. Fondi fillestar i miratuar për këtë zë ka qenë në shumën 350 mijë lekë.

Gjatë procesit të rishikimit buxhetor, në funksion të nevojave reale dhe të evidentuara gjatë zbatimit të buxhetit, fondi përkatës është rishikuar në shumën 2.1 milion lekë. Nga ky fond janë shpenzuar gjithsej 1.9 milion lekë, çka përfaqëson rreth 91% të planit vjetor përfundimtar.

Në ndarjen institucionale të shpenzimeve, Prokuroria ka realizuar shpenzime në vlerën 1.2 milion lekë, ndërsa Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) ka shpenzuar shumën 649 mijë lekë. Këto shpenzime lidhen drejtpërdrejt me përballimin e situatave të paparashikuara dhe nevojave emergjente, në përputhje me qëllimin e fondit të veçantë.

Gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë veprime konkrete për alokimin e burimeve financiare, si dhe është paraqitur kërkesë për fond shtesë në shumën totale prej 1.7 milion lekë, e argumentuar nga rritja e nevojave faktike dhe domosdoshmëria për garantimin e funksionimit normal të institucioneve përkatëse.

Shpenzime për Investime Kapitale (231)

Në mbështetje të ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, fondi i miratuar fillimisht për zërin **Investime Kapitale (Ilogaria ekonomike 231)** ka qenë në shumën 700 milion lekë. Si rezultat i shtesave dhe pakësimeve buxhetore të reflektuara gjatë procesit të miratimit dhe rishikimit të buxhetit, plani i rishikuar për këtë zë është përcaktuar në shumën 358 milion lekë.

Gjatë periudhës 12-mujore të vitit 2025, shpenzimet faktike për investimet kapitale kanë arritur vlerën 293 milion lekë, ose rreth 82% të planit vjetor përfundimtar.

Realizimi i investimeve kapitale gjatë vitit 2025 ka rezultuar në nivele më të ulëta krahasuar me planifikimin fillestar, fakt i cili lidhet ngushtësisht me ecurinë e punimeve për rikonstruksionin e godinës kryesore të institucionit. Ky proces përfshin ndërhyrje të thelluara dhe komplekse, të cilat kërkojnë kohë të konsiderueshme për projektim, zbatim dhe kolaudim.

Rikonstruksioni i godinës nuk kufizohet vetëm në ndërhyrje fizike mbi strukturën ekzistuese, por shoqërohet edhe me investime të ndërlidhura, si instalime teknike, sisteme infrastrukturore moderne, pajisje sigurie dhe elementë funksionalë, të domosdoshëm për garantimin e standardeve të sigurisë, cilësisë dhe jetëgjatësisë së projektit. Këta faktorë kanë ndikuar drejtpërdrejt në ritmin e realizimit të shpenzimeve kapitale gjatë vitit raportues.

Tabela nr.7: Projektet e shpenzimeve kapitale

Kodi produktit	Projekti/Produkti	Plani vjetor	Plani i rishikuar	Fakti 2025	Diferenca Plan/Fakt	% e realizimit
Projekti Pajisje Administrative		197,830,570	113,931,080	99,863,480	14,067,600	88%
19AA603	Blerje Pajisje Zyre	93,293,570	56,106,600	42,039,000	14,067,600	75%
19AA604	Blerje Automjete	35,000,000	24,152,000	24,152,000	-	100%
19AA605	Blerje Pajisje Elektronike	60,537,000	33,672,480	33,672,480	-	100%
19AA606	Blerje pajisje operationale dhe te teknikes operative	9,000,000	-	-	-	-
Projekti Ndërtim muri rrethues		2,686,700	2,647,902	2,641,067	6,835	100%
23AB901	Ndërtim muri rrethues	1,850,000	1,850,000	1,843,261	6,739	100%
23AB903	Supervizim lidhur me projektin e murit	136,000	136,000	135,906	94	100%
23AB904	Kolaudim lidhur me projektin e murit	50,000	11,202	11,202	-	100%
23AB905	Shpronësimit trualli per murin rrethues	650,700	650,700	650,698	2	100%
Projekti Punime rikonstruksioni Godina e re dhe ndërtimi urë komunikuese midis dy godinave:		464,482,730	232,274,078	190,214,248	42,059,830	82%
23AC302	Punime rikonstruksioni Godina e Re dhendertimi ure komunikimi midis dy godinave	459,002,730	230,297,629	188,426,023	41,871,606	82%
23AC304	Supervizim	4,680,000	1,976,449	1,788,225	188,224	90%
23AC305	Kolaudim	800,000	-	-	-	-
Projektet e reja		35,000,000	9,680,940	-	9,680,940	0%
24AH801	Panele diellore per prodhim energji elektrike ne funksion te institucionit te Spak	11,000,000	9,680,940	-	9,680,940	0%
24AH901	Kosto per sisteme dhe infrastrukture TIK (siguria kibernetike)	24,000,000	-	-	-	0%
Total		700,000,000	358,534,000	292,718,795	65,815,205	82%

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2025);

Si një strukturë ligjzbatuese, SPAK paraqet nevoja specifike infrastrukturore, të cilat përfshijnë ndërtimin dhe rikonstruksionin e ambienteve të sigurta dhe funksionale, pajisjen me teknologji të avancuar për hetimin dhe analizën e të dhënave, si dhe krijimin e sistemeve të integruara për menaxhimin e informacionit dhe bazave të të dhënave. Përdorimi i mjeteve të sofistikuar të përgjimit, analizës së informacionit dhe inteligjencës digjitale është jetik për përmbushjen e misionit të institucionit, ndërsa investimet në sigurinë kibernetike mbeten një prioritet strategjik për garantimin e mbrojtjes së informacionit të klasifikuar dhe të dhënave sensitive.

Me Aktin Normativ nr. 11, datë 19.12.2025, “Për ndryshimin e ligjit nr. 115/2024 Për buxhetin e vitit 2025”, bazuar në deklarinimin e tepricave të fondeve buxhetore të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), është miratuar pakësimi i fondeve buxhetore në shumën 341 milion lekë për zërin përkatës.

Si rrjedhojë, fondet e papërdorura janë evidentuar dhe deklaruar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, duke çuar në rishikimin përkatës të buxhetit dhe në pakësimin e fondeve të miratuara për këtë zë.

Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit

Gjatë vitit 2025, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka përfituar financim në formën e grantit, në shumën totale 664 mijë lekë, në kuadër të *Programit të financimit të Ekipeve të Përbashkëta Hetimore (EPH) të Eurojust/Crimjust*.

Ky financim ka pasur si qëllim mbështetjen e aktiviteteve hetimore ndërkombëtare dhe është përdorur në përputhje me kushtet e marrëveshjes përkatëse, duke mbuluar shpenzime të natyrës mbështetëse si udhëtimet, akomodimin, përkthimin, interpretimin, si dhe shërbime të tjera të nevojshme për funksionimin e EPH-ve.

Për zërin “**Mallra dhe shërbime**”, shpenzimet e kryera nga fondi i akorduar në formë granti janë realizuar në vlerën totale të financimit, duke rezultuar në një nivel realizimi 100%.

Tabela nr.8: Shpenzime të kryera nga fondi i Grantit - kap. 6 (Eurojust-Crimjust)

Kap.6	Nënlllogaria ekonomike	Emërtimi	Granti i akorduar	Shuma e shpenzuar
6	602	Shpenzime per Prokurorinë e Posacme	664,205	664,205
6	602	Shpenzime për Byronë Kombëtare të Hetimit	-	-
Total			664,205	664,205

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2025);

Ky tregues dëshmon një përdorim efektiv dhe të qëllimshëm të fondeve të grantit, në funksion të forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rritjes së eficiencës së veprimtarisë hetimore të Prokurorisë së Posaçme.

4.2.PERFORMANCA JO-FINANCIARE E PROGRAMIT BUXHETOR

Realizimi i produkteve buxhetore në nivel performance për Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për vitin 2025 është monitoruar dhe vlerësuar sipas treguesve të performancës të përcaktuar në programin “Veprimtaria e SPAK”.

Tabela nr. 9: Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit.

Treguesit e performancës/Produktet:					
Emërtimi i Treguesit të Performancës/Produktit	Niveli faktik i vitit 2024	Niveli i planifikuar në vitin 2025	Niveli faktik viti 2025	% e Realizimit të Treguesit të Performancës/Produktit	Sqarime
Raporti midis numrit të çështjeve të përfunduara(hetuara) kundrejt atyre të regjistruara(nën hetim).	66%	60%	73%	122%	Për 12 mujorin e vitit 2025, çështje nën hetim, të regjistruara 294 çështje. Të zgjidhura nr 216 (54 për gjykim+58 pushim +63 transferuar për kompetencë+41 pezulluar)
Raporti midis numrit të çështjeve të dërguara për gjykim kundrejt atyre të përfunduara(hetuara).	29%	45%	25%	56%	Për 12 mujorin janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim 54 procedime penale nga 216 të zgjidhura
Raporti midis numrit të personave të hetuar kundrejt atyre të regjistruar(nën hetim).	53%	70%	53%	75%	Për vitin 2025 ka përfunduar hetimi për 440 persona nga 838 persona nën hetim
% e grave në poste drejtuese të institucionit ndaj totalit të posteve drejtuese	36%	50%	48%	96%	Nr. i posteve drejtuese gra (aktualisht 13) mbi totalin e posteve drejtuese (totali 27)

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Dokumentacionit dhe Shërbimeve 2025;


Referuar tabelës më sipër konstatohet se produktet buxhetore kanë një nivel realizimi të kënaqshëm, duke reflektuar një qasje të qëndrueshme dhe të orientuar drejt objektivave të përcaktuara.

Lidhur me treguesi 94101AB “*Dosje të përfunduara*”, tregon mënyrën e përpunimit të çështjeve në kuadër të detyrave të SPAK-ut:

- Gjatë periudhës 12-mujore të monitorimit, numri i çështjeve të përfunduara ishte rreth 216 çështje, nga një total prej 294 çështjesh të regjistruara gjatë vitit 2025, duke rezultuar në një nivel realizimi 73% në raport me totalin e çështjeve të regjistruara;

Ky tregues ofron një pasqyrë të qartë mbi nivelin e përpunimit dhe përfundimit të çështjeve, duke reflektuar efektivitetin e veprimtarisë së SPAK-ut dhe aftësinë e institucionit për të përmbushur objektivat strategjike dhe detyrimet e përcaktuara ligjërisht.

Grafiku nr.5: Treguesit e performancës



Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2025);

Në përfundim, performanca jo-financiare e programit për vitin 2025 tregon një nivel të qëndrueshëm të realizimit të objektivave operative, duke ofruar një bazë për përmirësime të mëtejshme në proceset e menaxhimit të çështjeve dhe alokimin e burimeve në funksion të rezultateve të pritshme.

4.3. VEPRIMET VIJUESE NË NIVELIN E PROGRAMIT BUXHETOR

Bazuar në analizën e përdorimit të fondeve buxhetore gjatë vitit 2025, SPAK synon të përdorë burimet financiare me eficiencë dhe efektivitet maksimal, në funksion të realizimit të objektivave të programit dhe rritjes së nivelit të performancës së treguesve të Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Prioritet kryesor mbetet përfundimi i procedurës për investimin me objekt: “Rikonstruksionin e godinës së re dhe ndërtimin e urës lidhëse”. Ky projekt është jetik jo vetëm për krijimin e mjediseve funksionale dhe të sigurt për punonjësit aktualë të SPAK, por edhe për:

- Sigurimin e vijmësisë së investimeve të lidhura, si mobilimi i hapësirave dhe pajisja me teknologji elektronike;
- Krijimin e bazës për zgjerimin e stafit, duke përfshirë rekrutimin e hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe punonjësve të tjerë, në përputhje me strukturën organizative të miratuar;
- Përmirësimin e efikasitetit operativ, duke mundësuar një ambient pune të qëndrueshëm dhe të sigurt, i domosdoshëm për realizimin e misionit të institucionit.

5. PROJEKTET KAPITALE

Gjatë vitit 2025, Prokuroria e Posaçme është angazhuar në realizimin e disa projekteve të rëndësishme:

Projekti “Pajisje Administrative”:

Ky projekt në vitin 2025 ka një fond total të rishikuar prej 113,931,080 lekë, prej të cilave janë realizuar 99,863,480 lekë, që përkthehet në një nivel realizimi prej rreth **88%** sipas produkteve kryesore. Kjo tregon se blerjet janë kryer pjesërisht, por ka pasur vonesa ose shtyrje në përfundimin e disa procedurave, veçanërisht për pajisjet më të specializuara.

Projekti ka realizuar në mënyrë të mirë blerjet për automjetet dhe pajisjet elektronike, me përqindje realizimi 100%. Për blerjen e pajisjeve të zyrës është realizuar vetëm 75% e fondit të planifikuar, që kërkon vëmendje për përfundimin e procedurave të mbetura dhe përmirësimin e likuidimit financiar.

1. Produkti me kod 19AA603 “Blerje pajisje zyre” me fond buxhetor të rishikuar në vlerën 56 milion lekë. Procedura është përfunduar, por realizimi është 75% në vlerën 42 milion lekë. Diferenca e palikujduar rreth 14 milion do vijoi gjatë vitit 2026.
2. Produkti me kod 19AA604 “Blerje Automjete” me fond buxhetor të rishikuar në vlerën 24 milion lekë. Procedurë e cila është realizuar dhe likujduar 100% në vlerën rreth 24 milion lekë.
3. Produkti me kod 19AA605 “Blerje të pajisjeve dhe sistemeve elektronike” me fond buxhetor të rishikuar në vlerën 33 milion lekë. Procedurë e cila është realizuar dhe likujduar 100% në vlerën rreth 33 milion lekë.
4. Produkti me kod 19AA606 “Blerje pajisje operacionale dhe teknike operative”. Gjatë procesit të rishikimit të buxhetit për vitin 2025, pasi u shqyrtua se blerja e pajisjeve operacionale dhe teknike nuk do të realizohej brenda vitit, fondi i parashikuar për këtë zë u pakësua dhe për pasojë buxheti për këtë kategori u hoq plotësisht. Kjo vendimarrje do të monitorohet dhe planifikohet për realizim në vitet në vijim, në përputhje me nevojat operacionale të institucionit.

Projekti “Ndërtim muri rrethues”:

Ky projekt në vitin 2025 ka një fond total të rishikuar prej 2,647,902 lekë, prej të cilave janë realizuar 2,641,067 lekë. Projekti është realizuar në një nivel shumë të lartë, duke arritur pothuajse **100%** të fondit të rishikuar. Kjo tregon një përfundim të suksesshëm të punimeve kryesore, duke përfshirë ndërtimin, supervizimin dhe kolaudimi.

1. Produkti me kod 23AB901 “Ndërtim muri rrethues” parashikuar në vlerën 1.8 milion lekë. Procedurë e realizuar 100% dhe likujduar në vlerën rreth 1.8 milion lekë. Punimet e ndërtimit janë kryer në mënyrë të plotë.
2. Produkti me kod 23AB903 “Supervizim lidhur me projektin e murit” parashikuar në vlerën 136 mijë lekë, e cila është realizuar 100% dhe likujduar në vlerën rreth 135 mijë lekë. Supervizimi është kryer dhe likuiduar në përputhje me planin e miratuar.
3. Produkti me kod 23AB904 “Kolaudim lidhur me projektin e murit” me fond buxhetor të rishikuar në vlerën 11 mijë lekë, e cila është realizuar 100% dhe likujduar në vlerën rreth 11 mijë lekë.

4. Produkti me kod 23AB905 “Shpronësim trualli” parashikuar në vlerën 650 mijë lekë, është përfunduar si procedurë dhe likuiduar 100% me vlerë 650 mijë lekë.

Projekti “Punime rikonstruksioni Godina e re dhe ndërtimi urë komunikuese midis dy godinave”:

Ky projekt në vitin 2025 ka një fond total të rishikuar prej 232,274,078 lekë, prej të cilave janë realizuar 190,214,248 lekë, që përkthehet në një nivel realizimi prej rreth **82%** sipas produkteve kryesore. Projekti ka përparuar mirë gjatë vitit 2025 me një realizim të konsiderueshëm të punimeve dhe supervizimit, ndërsa faza e kolaudimit është ende në pritje për shkak të mbarimit të vonuar të punimeve. Vazhdimi i projektit në vitin 2026 është i nevojshëm për finalizimin e të gjithë punimeve dhe për përmbylljen e plotë të këtij investimi të rëndësishëm

1. Produkti me kod 23AC302 “Punime rikonstruksioni Godina e re dhe ndërtim urë lidhëse” me fond buxhetor të rishikuar në vlerën 230 milion lekë. Procedurë e realizuar si dhe likuiduar pjesërisht me vlerë 188 milion lekë. Punimet kryesore janë realizuar dhe likuiduar pjesërisht rreth 82%. Projekti vazhdon në vitin 2026 për përfundimin e punimeve të mbetura.
2. Produkti me kod 23AC304, “Supervizim projektim” me fond buxhetor të rishikuar në vlerën 1,9 milion lekë. Procedura është përfunduar si dhe likuiduar 90% me vlerë 1,7 milion lekë
3. Produkti me kod 23AC305 “Kolaudim” Gjatë procesit të rishikimit të buxhetit për vitin 2025, pasi u shqyrtua se ky produkt nuk do të realizohej brenda vitit, fondi i parashikuar për këtë zë u pakësua dhe për pasojë buxheti për këtë kategori u hoq plotësisht. Procedura e kolaudimit nuk është realizuar për shkak se punimet nuk janë përfunduar ende.

Projektet e reja:

Projekti ka një fond total të rishikuar prej 9,680,940 lekë, por gjatë vitit 2025 nuk ka pasur realizim financiar, që përkthehet në një nivel realizimi prej **0%**. Arsyeja lidhet me përfundimin e punimeve për njërin produkt dhe mungesën e zhvillimit të procedurës për tjetrin. Pjesa e punimeve për panelin diellor është përfunduar, duke lejuar likuidimin në vitin 2026. Projekti për sistemet TIK të monitorohet dhe planifikohet për vitin e ardhshëm. Kjo reflekton nevojën për planifikim më të mirë të kohës dhe përqendrimin e burimeve për përfundimin e projekteve kapitale.

1. Produkti me kod 24AH801 “Panele diellore për prodhim energji elektrike” me fond buxhetor të rishikuar në vlerën 9.6 milion lekë. Procedura është përfunduar, por likuidimi nuk është kryer për shkak se punimet nuk mbaruan brenda vitit; pagesa pritët në vitin 2026.
2. Produkti me kod 24AH901 “Kosto për sisteme dhe infrastrukture TIK siguria kibernetike”. Gjatë procesit të rishikimit të buxhetit për vitin 2025, pasi u shqyrtua se ky produkt nuk do të realizohej brenda vitit, fondi i parashikuar për këtë zë u pakësua. Procedura nuk është zhvilluar gjatë vitit 2025, ndaj nuk ka realizim financiar. Aktiviteti do të vijojë në vitet e ardhshëm.

5.1 GRANTET KAPITALE

Në vijim të kërkesës së paraqitur nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për financimin e dy projekteve, Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka marrë Vendimin nr. 188 datë 09.06.2025 “Mbi financimin e projekteve të SPAK nga Fondi i Posaçëm ” si më poshtë;

- Pajisje teknologjike për qëllime operative – IMSI Catcher”. Çmimi i vlerësuar 1.8 milion euro.
- Upgrade i sistemit të përgjimit. (Përmirësim të sistemit në versionin më të fundit MC22, Shtim të modulit IP Data (MPD), Rritje të memories së brendshme (Data Storage). 3.3 milion euro

Gjatë vitit 2025, është paraqitur nevoja për shtesë financimi në vlerën 121 milion lekë, me qëllim mbulimin e plotë të TVSH-së për dy projekte me rëndësi të veçantë operative. Kjo shtesë financimi është miratuar me Vendimin e Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar nr. 215, datë 06.11.2025.

Projekte të cilat priten të realizohen gjatë vitit 2026.

6. NDRYSHIMET NË BUXHET

Në zbatim të ligjit vjetor “Për zbatimin e buxhetit viti 2025”, drejtorja e buxhetit ka analizuar dhe detajuar fondet në përputhje me shpërndarjen e fondeve buxhetore të miratuara. Përgjatë vitit 2025, ka marrë masat korrigjuese nëpërmjet rialokimeve të fondeve (shtesa /pakësime). Çdo kërkesë për fonde shtesë ose rishpërndarje fondesh, apo pakësimet e mundshme janë shoqëruar me analizë ku identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, kontributi në arritjen e qëllimit dhe objektivave dhe risqet e lidhura. Bazuar në Aktet normative për ndryshimin e ligjit buxhetor, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, janë kryer detajimet përkatëse sipas rishikimit të buxhetit.

Rrjedhë e ndryshimeve të akteve ligjore/nënligjore, i referohemi këtu;

- Me shkresën nr. 3067/1, datë 19.02.2025 në zërin shpenzime korrente si rezultat i detajimit të fondit të veçantë është miratuar vlera prej 350 mijë lekë,
- Me shkresën nr. 6054/1, datë 14.04.2025 si rezultat i kërkesës shtesë të fondit të veçantë është miratuar vlera e shtuar prej 649 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 42995, datë 16.12.2025 si rezultat i kërkesës shtesë të fondit të veçantë është miratuar vlera e shtuar prej 1,112 milion lekë.
- Me aktin normative Nr. 6, datë 11.06.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025” janë reflektuar ndryshime në buxhet, konkretisht pakësime në zërat buxhetor me vlerë totale 20 milion lekë Detajimet përkatëse janë reflektuar në muajin Qershor.

- Me aktin normative Nr. 10, datë 08.10.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025” janë reflektuar ndryshime në buxhet, konkretisht pakësime në zërat buxhetor me vlerë totale 466 milion lekë. Detajimet përkatëse janë reflektuar në muajin Tetor.
- Me aktin normative Nr. 11, datë 19.12.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025” janë reflektuar ndryshime në buxhet, konkretisht pakësime në zërat buxhetor me vlerë totale 405 milion lekë. Detajimet përkatëse janë reflektuar në muajin Dhjetor

7. PËRFUNDIME

Menaxhimi financiar i Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjatë vitit 2025 ka synuar përdorimin efektiv të burimeve buxhetore për arritjen e objektivave strategjike të institucionit. Shpenzimet janë fokusuar kryesisht në tre fusha prioriteti:

Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore

Financimi ka siguruar krijimin e kapaciteteve të nevojshme për Prokurorët, Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) dhe personelin administrativ, duke mbështetur arritjen e rezultateve pozitive në luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit.

Përdorimi i teknologjisë së avancuar

Fondet janë orientuar drejt sigurimit të teknologjisë më të avancuar për ekspertizë dhe hetime proaktive, në përputhje me kompetencat ligjore të Prokurorisë së Posaçme dhe BKH, për të përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e proceseve hetimore.

Përmirësimi i infrastrukturës

Shpenzimet kapitale janë përdorur për përmirësimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të punës, duke siguruar ambient funksional dhe të sigurt për punonjësit, si dhe duke mbështetur kryerjen e procedurave hetimore në mënyrë efektive.

ANEKSI nr.1 Raporti Përmbledhës i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit Buxhetor

Emri i Grupit		Kodi i grupit 41										
EMËRTIME		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit										
		Viti paraardhës 2024		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		
